

Tiranë, 30.03.2021

## **PROBLEMATIKA DHE GJASHTË REKOMANDIME PRIORITARE LIDHUR ME SISTEMIN E DREJTËSISË<sup>1</sup>**

Në datën 22 korrik 2016, nga dhe përmes orësh të gjata negociatash Parlamenti Shqiptar miratoi me 140 vota “pro” dhe asnjë “kundër” reformën në drejtësi, e mbështetur fuqimisht nga BE dhe SHBA. Prej kujtudo brenda dhe jashtë Shqipërisë kjo reformë u konsiderua si historike, dhe një hap madhor në rrugën e integritit europian të Shqipërisë.

Më shumë se katër vjet më vonë, suksesi i reformës në drejtësi është vlerësuar gjerësisht nga qeveria shqiptare dhe partnerët ndërkombëtarë. Gjithsesi, vihen re se elemente si vonesat procedurale në procedurat e verifikimit gjatë vetingut, mbingarkesa e shfaqur për shkak të vakancave në dem të garantimit të procesit të rregullt ligjor dhe respektimi i afateve të arsyeshme në dhënien e drejtësisë ende nuk kanë arritur të përmbushin standardet e kërkuara. Përparimi i ngadaltë i zbatimit të reformës ka ndikuar drejtpërdrejt në funksionimin normal të organeve të sistemit, duke shkaktuar një numër të konsiderueshëm vakancash në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë në vend, referuar të gjitha niveleve.

Nga ana tjetër, vihet re se procesi i rivlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve (vetting), megjithëse me vonesa, vijon të shkaktojë vakanca të konsiderueshme në gjykata dhe prokurori, gjë e cila është shoqëruar me një ndikim në mbarëvajtjen e rregullt të procedurave, volumit të ngarkesës, shpërndarjes së saj dhe afateve në dhënien e drejtësisë. Sfidat politike dhe teknike që përkojnë gjatë zbatimit të reformës kanë çuar në një numër

---

<sup>1</sup> Ky material është produkt i ISP në kuadër të projektit "Reforma: për një ritëm cilësor. Monitorim, sensibilizim dhe asistencë" është duke u zbatuar nga ISP me mbështetjen e programit të shtetit të së drejtës të fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Pikëpamjet e shprehura janë përgjegjësi vetëm e ISP-së.

në rritje të çështjeve gjyqësore të prapambetura, për të cilat gjykatat duhet të marrin një vendim. Qytetarët, si përfituesit përfundimtarë të reformës, nuk kanë pasur ende mundësinë për të marrë drejtësi duke hasur një vonesë të vazhdueshme në çështjet e tyre dhe duke zbehur shpresat për të marrë një vendim profesional të gjyqësorit në kohë.

Në këtë drejtim, procesi i vetingut duket se nuk është shoqëruar me një plan të menduar mirë për plotësimin e pozicioneve vakante nga gjyqtarët e shkarkuar gjatë periudhës së reformimit. Gjykatat e Apelit janë prekur veçanërisht nga procesi i rivlerësimit dhe ende duhet kohë për të krijuar trupën e re të gjyqtarëve. Qytetarëve – përfituesit fundor të reformës por më të rëndësishmit – ende ju duhet të presin qoftë edhe për shqyrtimin gjyqësor të një mosmarrëveshjeje për regjistrimin e nje fëmije në regjistrin e gjendjes civile (shpesh e konsideruar e drejta për të përfituar të drejta). Ndaj Shqipëria sot e gjen veten përpara një situatë të vështirë të sundimit të ligjit e shoqëruar kjo me probleme politike të brendshme, të cilat vijnë, krahas gjendjes të brishtë të demokracisë, duke rrezikuar të ndikojnë negativisht në rezultatet e pritura të reformës. Gjatë viteve të kaluara, frytet e reformës për numrin e lartë të të shkarkuarve kanë qenë kryefjala e saj, por tashmë vëmendja e institucioneve, duhet të jetë më e përqendruar tek eliminimi i pasojave negative që kanë shkaktuar këto vakanca dhe në tërësi, të pritshmërive për përmirësimin e standardeve për dhënien e drejtësisë.

Sipas Raporti Vjetor të KLGj-së për vitin 2019 është evidente për sistemin gjyqësor, rritja e stokut të çështjeve të mbartura në rang vendi, duke përjashtuar Gjykatën e Lartë, është sërish në nivel të konsiderueshëm, me një rritje prej rreth 18% për 2019 (nga 49 196 çështje të mbartura në 2018 në 58291 çështje që mbarten nga viti 2019).

	2018		2019		2018	2019
	Me GJL	Pa GJL	Me GJL	Pa GJL	Ndryshimi ne % me GJL	Ndryshimi në % pa GJL
<b>Stoku i çështjeve civile</b>	37656	22640	47168	29598	25%	31%
<b>Stoku i çështjeve penale</b>	14291	10185	16559	11515	16%	13%
<b>Stoku i çështjeve administrative</b>	25906	16371	28875	17178	11%	5%
<b>TOTAL</b>	77853	49196	92602	58291	19%	18%

Vetëm numri i çështjeve të mbartura nga viti 2018 për në vitin 2019, është në total 77 853 çështje. Shpërndarja e stokut të çështjeve të mbartura sipas gjykatave është në proporcion të drejtë me numrin total të çështjeve ose me ngarkesën e punës që përballojnë këto gjykata. Numrin më të madh të çështjeve të mbartura e mbajnë Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë, çështjet

e mbartura të cilave përbëjnë 55 972 çështje ose rreth 72% të totalit të çështjeve të mbartura në shkallë vendi.

Po sipas Raportit Vjetor të KLGJ-së në vitin 2019 u regjistruan 152 399 çështje në shkallë vendi. Nga këto 123 481 çështje janë regjistruar si të tilla për herë të parë, pranë gjykatave të shkallës së parë, 22 769 janë çështjet që janë regjistruar në gjykatat e apelit, nëpërmjet ankimit ose çështje në juridiksion fillestar të këtyre gjykatave, ndërsa 6 149 çështjet e regjistruara në Gjykatën e Lartë.<sup>2</sup>

## REKOMANDIME PRIORITARE

**1. Harta e re gjyqësore që detyrimisht do të çojë në mbylljen e disa gjykatave dhe/ose bashkimi i tyre me gjykata të tjera. Kjo gjë mund të ndihmojë një shpërndarje me racionale të burimeve të disponueshme, por është e rëndësishme që në këtë proces të mos nënvlerësohen rreziqet e mundshme për sa i përket aksesit të individëve në gjykatë. Në një shoqëri demokratike duhet të ketë konsultime të përshtatshme për reformat e propozuara me ata që mund të preken prej tyre. Konsultimi i gjerë i përpjekjeve dhe produktit të hartës së re gjyqësore është i dobishëm jo vetëm për të siguruar që ka një vëmendje të gjerë për ndryshimet e propozuara nga ata që kanë gjasa për t'u prekur prej tyre, por edhe për të mundësuar që procesi i reformës të ecë përpara siç duhet nëpërmjet marrjes së informacionit dhe komenteve përkatëse nga palët e interesuara, shumë prej të cilëve kanë përvojë ose ekspertizë të vlefshme.**

**2. Vonesa në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore dhe më specifikisht e drejta për t'ju drejtuar gjykatës dhe për të marrë prej saj një vendim brenda një afati të arsyeshëm kohor (sikundër parashikojnë në shumë raste dispozitat e në ligjet procedurale dhe ligjet e veçanta) nuk duhet të jetë kosto që e paguan qytetari i thjeshtë. Sic shprehet edhe Gjykata Kushtetuese<sup>3</sup> ngarkesa dhe/ose vakanca e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e çështjeve brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Institucionet qeverisëse të sistemit të drejtësisë duhet**

---

<sup>2</sup> <http://klgj.al/wp-content/uploads/2020/09/RAPORTI-VJETOR-2019-pdf.pdf>

<sup>3</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 80 datë 18.12.2017 30. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se justifikimi në raste të ngjashme se shkak i vonesës në shqyrtimin e çështjes është numri i lartë i çështjeve në ngarkim të këtyre gjykatave, nuk është i bazuar. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt, është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatë të Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (shih vendimet nr.57, datë 25.07.2017; nr.59, datë 16.09.2016; nr.69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

31. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimin të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm, është i bazuar.

*menjëherë të marrin në shqyrtim dhe t'i japin përgjigje institucionale këtij fenomeni duke marrë dhe parashikuar masa afatshkurtra dhe afatmesme për të eliminuar këtë shkelje të procesit të rregullt ligjor në përmasa kaq të mëdha.*

*Kuvendi i ri i Shqipërisë që del nga zgjedhjet e 25 prillit 2021 është e nevojshme të ndërmarrë një revision të bazës ligjore të reformës në drejtësi për të realizuar çdo ndërhyrje të nevojshme ligjore për të përshpejtuar ritmet e reformës, plotësimin e bollëqeve apo ngërçeve institucionale dhe në përgjithësi garantimin e procesit të rregullt ligjor për çdo çështje në gjykatat e vendit.*

*3. Aksesit i individëve në gjykatë procedimet e gjykatës brenda një afati të arsyeshëm kohor nuk janë “kosto” ose “shqetësim” për shtetin; përkundrazi ato janë mjete në një shtet të së drejtës për të mbrojtur të drejtat e individëve (veçanërisht atyre më të cenueshëm) dhe për të konfirmuar epërsinë e ligjit. Për këtë arsye, është me rëndësi themelore sistemi gjyqësor duhet të ketë burimet e përshtatshme njerëzore dhe financiare për të kryer punën e tij normale në kohën e duhur.*

*4. KLGJ ka hartuar dhe ka miratuar Planin Strategjik 2019-2020. Strategjia dhe plani i veprimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, paraqiten si dokumente tepër ambicioze. Synimet dhe objektivat kanë përcaktuar elementët thelbësorë të funksionimit të sistemit gjyqësor, megjithatë afati kohor në të cilin këta objektiva pritet të realizohen është jo realist. Periudha e parashikuar për të implementuar planin e veprimit konsiderohej Dhjetori i 2020. Një periudhë prej 1 viti e 5 muaj (plani u miratua dhe hyri në zbatim që në korrik 2019) është e pamjaftueshme për të realizuar objektiva madhorë si bërja funksionale e gjykatave, akordimi i burimeve, reduktimi i ngarkesës gjyqësore, rritja e efikasitetit të gjykatave etj. Sugjerohet që strategjia e re që duhet të miratohet të synohet për t'u implementuar për një afat më të gjatë në kohë dhe të identifikohen më realisht dhe më konkretisht instrumentat matëse për periudhën e caktuar, ose të shprehet në përqindje se në çfarë mase është objektive të implementohet një objektivi për një periudhë të caktuar. Po ashtu brenda këtyre objektivave të identifikuar, mund të përcaktohet cilët prej tyre janë më prioritarë për t'u zbatuar (për shembull në vitin e parë të implementimit të strategjisë) dhe objektivat e tjerë të shtrihen në kohë.*

*Synimi që lidhet me “Ofrimi Efikas i Shërbimeve dhe funksionimi më i Mirë i Gjykatave” është tepër themelor, veçanërisht sepse ndikon drejtpërsëdrejti edhe tek perceptimi publik i cili përbën dhe një element themelor në misionin e KLGJ. Nga ana tjetër ai lidhet thellësisht me aksesin e qytetarëve në gjykata, dhe janë këto të fundit që kanë rolin kryesor në përmirësimin e aksesit edhe përmes kuadrit të ri ligjor për ndihmën juridike. Aktivitetet e parashikuara për këtë synim, sipas Planit 2019-2020 ishin që në fillim dukshëm të përealizueshme. Për shembull objektivi 3.3 që lidhet me miratimin e*

*rregullave të unifikuara, parashikonte si aktivitete, krijimin e një sërë rregullash e standardesh që praktikisht përfshijnë pjesën më të madhe të aspekteve të administrimit të gjykatave. Përveçse kjo ishte e pamundur të realizohet brenda periudhës së parashikuar, por dhe indikatorët matës nuk mund të përfshijnë 'zbatimin e standardeve të reja nga gjykatat', por përkundrazi ato duhet të kufizohen tek krijimi i udhëzuesve dhe aksesueshmëria e tyre brenda periudhës kohore të synuar.*

*5. Ndryshe nga KLGJ, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar Planin Strategjik për vitet 2021-2024. Nëpërmjet vendimit nr. 231, datë 27.10.2020 Këshilli i Lartë i Prokurorisë miratoi me akt nënligjor bazën juridike për të hapur garën për të emëruar drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm pa qenë e nevojshme që kandidatet për këto poste të kenë kaluar procesin e vettingut. Me miratimin e kësaj procedure ekziston rreziku i përplasjes së një rezultati të ndryshëm nga ai që do të japin institucionet e specializuara dhe të ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji për vettingun. Vendimi i KLP-së nuk ka asnjë mekanizëm apo parashikim sesi do të evitohet kjo përplasje p.sh në rast se sipas vettingut që bën KLP një kandidat plotëson kushtet për të qenë drejtues, ndërsa sipas KPK-së dhe/ose KPA-së i njëjti prokuror drejtues duhet t' shkakohet nga detyra e prokurorit. Vendimi i mësipërm po ashtu nuk ishte parashikuar për t'u miratuar si i tillë në Planin Strategjik të këtij institucioni.*

*6. KLP-ja dhe Prokurori i Përgjithshëm duhet të plotësojnë një element të munguar të veprimtarisë së tyre siç është studimi i ngarkesës së punës së prokurorëve, si e vetmja mënyrë për të pasur një politikë afatgjatë efikase të burimeve njerëzore në sistemin e prokurorisë. Ndërsa një komponent i tillë është prezent në çdo raport vjetor të KLGJ-së dhe përgjithësisht përbën një aspekt të veprimtarisë së saj me partnerët ndërkombëtarë, informacioni dhe këndvështrimi i këtyre dy institucioneve të prokurorisë për këtë gjë mungon tërësisht.*

*Procesi i draftimit dhe miratimit të hartës së re gjyqësore e ka jetike transparencën dhe gjithëpërfshirjen. Veçanërisht aty ku reformat e ndërmarra mund të ndikojnë në aksesin në drejtësinë është thelbësore që programi për ndryshim të përfshijë kryerjen e një procesi të qartë dhe të posaçëm të vlerësimit dhe rishikimit. Propozimet për racionalizim dhe riorganizim gjyqësor duhet të përcaktojnë qartë përfitimet dhe rezultatet e pritshme, financiare dhe të tjera, dhe për pasojë edhe kriteret sipas të cilave mund të vlerësohet suksesi i ndryshimeve. Nga ana tjetër, miratimi i hartës së re gjyqësore nuk mund dhe nuk duhet të shihet si kompetencë vetëm e institucioneve shtetërore të ngarkuara me ligj, për të cilën përjashtohet transparenca. Askush nuk është në dijeni të studimeve të bëra, të statistikave të analizuara, të arsyeve pse janë dhënë zgjidhjet e cituara më lart. Në këtë proces, të gjitha aktorët e tretë dhe të shoqërisë civile duket se janë të përjashtuar, gjë e cila cenon rëndë procesin nëse nuk do të merren masa për ta rikuperuar në kohë një të metë të tillë.*

7. *Neni 179/b i Kushtetutës parashikon se: “8. Mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik është 5 vjet nga data e fillimit të funksionimit tyre, ndërsa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Apelit është 9 vjet. Pas shpërbërjes së komisionit, çështjet e papërfunduara të rivlerësimit shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Çështjet e papërfunduara të rivlerësimit të prokurorëve shqyrtohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas ligjit. Pas shpërbërjes së komisionerëve publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Ankimet ndaj vendimeve të komisionit ende të papërfunduara do të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.”*

*Në datën 18.06 2022 mbaron mandati 5 vjeçar i qëndrimit në detyrë për KPK-në. Në rast se nuk do të ketë ndryshime kushtetuese për shtyrjen e këtij afati, dhe duke marrë në konsideratë faktin se sipas raportimeve në media është më shumë se gjysma e trupës së gjyqtarëve dhe prokurorëve që nuk i është nënshtruar ende vendimmarrjes së KPK-së, lind domosdoshmëri të fillojë puna për miratimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe akteve nënligjore për të mundësuar procedurën e kryerjes së vettingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve të mbetur, përkatësisht nga KLGJ dhe KLP. Duket se miratimi i këtyre ndryshimeve ligjore mbetet të bëhet nga Kuvendi i ri i zgjedhur pas datës 25 prill 2021 dhe kërkon miratimin me një shumicë të kualifikuar, pra të një konsensusi të gjerë pozitë-opozitë parlamentare, gjë e cila duket jo e lehtë të realizohet.*